



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 17, dt. 30. 01.2015

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.01.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet projekti “HEC-Lengarica”, në rrjedhën e lumit Petran, Rrethi Përmet.
2. Shoqëria ngarkohet të kontribuojë në restaurimin e monumenteve: Kisha e Bënjës, Ura e Katiut dhe Mulliri i Drithit , sipas projekteve të hartuara nga IMK.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI